

RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2025 DHE BUXHETI PËR VITIN 2026

I. RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2025

(Të hyrat dhe shpenzimet – periudha maj–dhjetor 2025)

I. KONTEKSTI INSTITUCIONAL DHE PERIUDHA E RAPORTIMIT

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) ka filluar funksionimin institucional në muajin mars 2025 dhe raporti financiar për vitin 2025 përfshin periudhë të pjesshme raportimi, konkretisht nga muaji maj deri më 23 dhjetor 2025.

Ky raport pasqyron fazën fillestare të konsolidimit institucional dhe i paraqitet Kuvendit si pjesë integrale e raportit vjetor

2. BUXHETI I MIRATUAR PËR SHPENZIME PËR VITIN 2025

Për vitin 2025, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ka miratuar dhe subvencionuar buxhetin për shpenzime, si vijon:

- Paga dhe mëditje: 108,920.00 EUR
- Mallra dhe shërbime: 71,080.00 EUR
- Shpenzime të tjera: 20,000.00 EUR

Ky buxhet ka shërbyer si bazë krahasuese për analizën e realizimit buxhetor.



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2. TË HYRAT E REALIZUARA NË VITIN 2025

Gjatë periudhës maj–dhjetor 2025, OIRK ka realizuar të hyra totale në shumë prej 283,050.00 EURO, të gjeneruara kryesisht nga:

- kuotat e anëtarësisë,
- tarifat për licencim dhe rilicencim profesional,
- burime të tjera të lejuara nga korniza ligjore.

Këto të hyra janë inkasuar në llogarinë bankare të OIRK-së të hapur nga MMPHI dhe janë duke u mbajtur në mirëbesim nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ato nuk janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të vitit 2025, pasi shpenzimet operative janë financuar përmes buxhetit të miratuar nga Ministria.

4. Shpenzimet faktike dhe realizimi buxhetor 2025

- Paga dhe mëditje: 73,181.71 EUR (67.18% e buxhetit të aprovuar)
- Mallra dhe shërbime: 46,705.09 EUR (65.70% e buxhetit të aprovuar)
- Shpenzime të tjera: 1,553.69 EUR (7.8% e buxhetit të aprovuar)

Në asnjë kategori nuk është shënuar tejkalim i shpenzimeve kundrejt buxhetit të miratuar.

5. Vlerësim përmbledhës

Menaxhimi financiar gjatë vitit 2025 është karakterizuar me disiplinë buxhetore, ndarje e qartë e burimeve financiare dhe përdorim racional i fondeve. Realizimi më i ulët i shpenzimeve lidhet drejtpërdrejt me faktin se 2025 ka qenë viti i parë i funksionimit institucional të OIRK-së.



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

II. PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2026

(Të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara)

I. Hyrje

Plani i buxhetit për vitin 2026 është hartuar në përputhje me nevojat reale për funksionim institucional, me synim sigurimin e transparencës, realizueshmërisë dhe qëndrueshmërisë financiare.

2. Parimet e planifikimit buxhetor

Planifikimi për vitin 2026 bazohet në:

- projeksione realiste të të hyrave nga anëtarësia,
- Shpërndarje të burimeve financiare përmes granteve,
- lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpenzimeve dhe aktiviteteve,
- ruajtje të stabilitetit financiar dhe kapaciteteve administrative.

3. Lloji i të hyrave

• Aplikimet për licencë	48,000.00
• Anëtarësia: 1,900 anëtarë × 100 EUR =	190,000.00
• Aplikimet nga praktikantët	6,000.00
• Te hyrat nga donacionet	50,000.00
Total të hyrat për vitin 2026	294,000.00



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

4. SHPENZIMET

Shpenzimet për vitin 2026 janë planifikuar në përputhje me funksionet ligjore dhe statutore të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, si dhe me planin vjetor të aktiviteteve institucionale.

4.1 Paga, mëditje dhe kompensime

Përshkrimi	Shuma (Euro)
• Paga e stafit të Administratës, Kryetarit të Odës dhe mëditje për anëtarët e Bordit të OIRK-së	123,600.00
• Kompensime për anëtarët e komisionit të ankesave dhe disiplinor	21,600.00
• Kontributi pensional i punëdhënësit	5,436.00
Totali	150,636.00

4.2 Mallra dhe shërbime

Përshkrimi	Shuma (Euro)
• Mirëmbajtja vjetore e sistemit e-Licenca	20,000.00
• Edukimi i vazhdueshëm profesional	40,000.00
• Mirëmbajtja vjetore e faqes së Odës	2,508.00
• Pjesëmarrja në takime rajonale dhe konferenca ndërkombëtare	24,000.00
• Shpenzime të përfaqësimit dhe pritje zyrtare	12,000.00
• Shënimi i ditës së Inxhinierit dhe ndarja e çmimeve	10,000.00
• Organizimi i Kuvendit të rregullt dhe të jashtëzakonshëm	20,000.00



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përshkrimi	Shuma (Euro)
• Printimi i licencave, kartelave dhe vulave	4,920.00
• Marketing dhe materiale promovuese	5,000.00
• Blerje e pajisjeve IT (kompjuter, printer)	2,500.00
• Material zyre	10,800.00
• Internet dhe telefoni fikse mobile	2,400.00
• Qira mujore dhe shpenzime komunale të objektit	30,000.00
• Shpenzime te tjera	5,000.00
Totali	189,128.00

4.3 Përmbledhje e shpenzimeve për vitin 2026

• Paga, mëditje dhe kompensime	150,636.00
• Mallra dhe shërbime	189,128.00
• Shpenzime të paparashikuara	5,000.00
Total shpenzime 2026	344,764.00

5. Përfundim dhe rekomandim për Kuvendin

Plani i buxhetit për vitin 2026 paraqet një strukturë të balancuar të të hyrave dhe shpenzimeve, mbështetet në anëtarësi të qëndrueshme dhe krijon bazë të shëndoshë financiare për realizimin e misionit dhe objektivave strategjike të Odes së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.